

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Shukri Sylejmani anëtarë, në çështjen juridike të paditësve L1., K.,L2. dhe A. Sh. nga Prishtina, të cilët i përfaqëson av.Xh O., nga Prishtina, kundër të paditurve M. E.-S.,F. B.,K. B.-M.,V1. B.-B.,F1. B.-M.,F2. B. dhe V2. B., nga Prishtina, për shkak të vërtetimit të pronësisë dhe anulimit të pjesshëm të testamentit, duke vendosur sipas revizionit të paditësve paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1219/2015 datë 28.06.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 9.11. 2016, mori këtë,

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pathemeltë revizioni i paditësve paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1219/2015 datë 28.06.2016.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac.nr.1219/15 dt.28.06.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësve dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.1477/08 dt.31.10.2014, me të cilin me pjesën e I të dispozitivit të tij, është refuzuar kërkesëpadia e paditësve me të cilën kanë kërkuar që të anulohet pjesërisht testamenti T.nr.207/97 i dt.11.12.1997 dhe të vërtetohet se paditësit janë bashkëpronarë nga baza e trashëgimisë pas të ndjerit I. Sh. ish nga Prishtina, si vijon: 1/8 ose 376 m<sup>2</sup> nga 8/32 e pjesës ideale të ngas.kadastrale nr..., vendi quajtur "...", me kul.arë kl.3 e evidentuar në fp.nr..., ZK-Prishtinë në sip.të përgjithshme prej 0,90.70 ha, në 1/8 ose 46 m<sup>2</sup> të ngas.kadastrale nr..., në vendin e quajtur "ish ...", me kul.shtëpi, në sip, prej 170 m<sup>2</sup>, oborr në sipërf.prej 199 m<sup>2</sup>, në sip.të përgjithshme prej 369 m<sup>2</sup> e evidentuar në fp.nr..., ZK-Prishtinë, në 1/8 ose 576 m<sup>2</sup> të 1/3 të pjesës ideale të ngas.kadastrale nr..., v.quajtur "...", arë, kl.3 në sip.të përgjithshme prej 1.48,53 ha, e regjistruar në fp.nr..., ZK-Prishtinë dhe të detyrohet secili i paditur që paditësve në sipërfaqet e paluajtshmërive të përshkruara më lartë t'ia njohë të drejtën e pronësisë dhe t'ia lejojë regjistrimin e së drejtës së pronësisë në librat kadastrale, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kanosjen e përmbarimit të dhunshëm si dhe shpenzimet e

procedurës sipas llogarisë së gjykatës, si e pabazuar. Me pjesën e II, ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afat ligjor paditësit kanë paraqitur revizion , për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të miratohet revizioni, aktgjykimet e instancave më të ulëta të ndryshohen, duke aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve ose të njëjtit të prishen dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në revizion kanë paraqitur të paditurit, me propozim që revizioni i paditësve të refuzohet si i pathemeltë, ndërsa, aktgjykimi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë të vërtetohen.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion ka gjetur se:

Revizioni i paditësve është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paraardhësi i palëve ndërgjyqësore, trashëgimlënësi-testatori E. Sh. B. ish nga Prishtina, i vdekur me dt.4.07.2000, kishte patur dy martesë, pas vdekjes së bashkëshortes së parë, martohet me F. E.B.,ashtu që,nga martesë e parë kishte dy fëmijë I. Sh. (baba dhe bashkëshort i paditësve, i vdekur me dt.16.03.2008) dhe vajzën F. B. ,kurse, nga martesë e dytë kishte vajzat M.,F. K.,V. dhe djalin V.. Pas vdekjes së I. Sh. paditësit ushtrojnë padi kundër të paditurave, fillimisht, për vërtetimin e pronësisë e më pas edhe për anulimin e pjesërishtë të testamentit të testatorit E. B. i cili e kishte bërë me dt.10.12.1997, ndërsa,e kishte lënë në ruajtje me dt.11.12.1997 në Gjykatën Komonale në Prishtinë N.nr.204/97.Testamenti ishte shpallur pas vdekjes së tijë në seancën trashëgimore të dt.19.03.2002. Me aktvendimin për trashëgiminë të Gjykatës Komonale në Prishtinë T.nr.113/00 të dt.19.03.2002 ishin shpallur trashëgimtarët e trashëgimlënësit-testatorit E. B., sipas testamentit, vajzat dhe djali si dhe sipas ligjit bashkëshortja e tije (këtu të paditurit),në pjesët dhe paluajtshmërinë si në dispozitivin nën I dhe II të aktvendimit të sipër përmendur. Ndërsa, me pikën 7 të këtij testamenti, testatori shprehimisht ka theksuar se djalit të vet nga martesë e parë

I. Sh., me këtë rast nuk i lë asgjë nga arsyeja se për të gjallë të vet i ka siguruar mjetet për ndërtimin e dy shtëpive me lokal ashtu që ka qenë i detyruar t'a shes parcelën në sipërfaqe prej 40 ari në vendin e quajtur "Dragodan", ngas.kad.nr.6178 ZK-Prishtinë. Pra, sa ka qenë gjallë testatori E. B., paraardhësi i paditësve I. Sh., ka marrë pjesën e vet të trashëgimisë duke shfrytëzuar mjetet financiare nga ngas.kad.nr...., për të ndërtuar dy shtëpi dhe lokal afarist.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave dhe vërtetimit të kësaj gjendje faktike, ka gjetur se është e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve, ndërsa, lidhur me kërkesën për anulimin e pjesërishtë të testamentit, ka konstatuar se ajo është e pasafatshme pasi që paditësit kanë lëshuar afatin ligjor subjektiv të paraparë me dispozitën e nenit 69.1 të Ligjit mbi Trashëgiminë, e që është afat njëvjeçar nga dita kur personi që ka interes juridik ka marrë dijeni për testamentin, ndaj, ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të sajë.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke vlerësuar se drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët nuk janë përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare e as me shkelje të tjera të LPK-së, të pretenduara nga revizioni. Dispozitivi i aktgjykimit është i kjartë, në përputhje të plotë me arsyetimin, kurse, në arsyetim janë dhënë arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, andaj, konsideron se pretendimet e revizionit për shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale, nuk mund t'i vënë në pyetje aktgjykimet e instancave më të ulëta.

Gjykata Supreme e Kosovës, konsideron si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe arsyetimin e gjykatave të instancës më të ulët, përkitazi me refuzimin e kërkesëpadiës së paditësve, pasi që janë dhënë arsye bindëse dhe të pranueshme edhe nga kjo gjykatë. Prandaj, Gjykata e Revizionit, vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet e revizionit përkitazi me të metat rreth testamentit, keqbesimit përkatësishtë afatshmërisë së padisë për anulimin e pjesërishtë të testamentit. Kështu, sepse siç rrjedhë nga shkresat e lëndës, testamenti nga testatori E. B., është

bërë me dt.10.12.1997, kur edhe është bërë propozimi për ruajtjen e tijë në Gjykatën Komunale në Prishtinë me ç'rast ka marrë numrin N.204/97. Ky testament është shpallur në seancën trashëgimore me dt.19.03.2002. Me datën 30.07.2008, nga paditësit është ngritur padia kundër të paditurve për vërtetimin e pronësisë. Me datën 7.10.2011 paditësit me parashtrësë zgjerojnë padinë (në kuptimin subjektiv). Me datën 22.11.2013, paditësit me parashtrësë plotësojnë dhe precizojnë padinë , duke kërkuar tani, përveç, vërtetimit të pronësisë edhe anulimin e testamentit N... të dt.... (shih petitumin). Me datën 10.10.2014, paditësit sërish precizojnë kërkesë padinë, ashtu që tani kërkojnë anulimin e pjesërishtëm të testamentit të sipër përmendur. Në anën tjetër, në kontekstin e më sipërme, rezulton se në kohën e përpilimit të testamentit, testatori E. B., ka patur zotësinë për të bërë testament, ka patur zotësinë e veprimit, ka patur aftësinë për t'i kuptuar dhe gjykuar veprimet e veta (nuk ishte privuar nga zotësia e veprimit), kishte moshën e lejuar për bërjen e testamentit. Nuk është argumentuar me asnjë provë se testamenti është bërë (me vi clam precario) me mashtrim, shtrëngim, lajthim, përkatësisht se ka patur të meta në shprehjen e vullnetit të lirë të fundit të testatorit, (rrexueshmëria-nuliteti relativ i testamentit) sikundër që nuk del të jetë në kundërshtim me dispozitat imperative ligjore, me rendin juridik dhe rregullat e moralit (nuliteti absolut i testamentit). Nga sa u sipër theksua, rezulton se nuk qëndron pretendimi i revizionit se paditësit me parashtrësën për zgjerimin e padisë të dt. 7.10.2011 kanë kërkuar anulimin e testamentit, (në të vetëm flasin për ekzistimin e tijë në kontekst të një marrëveshjeje të dt. 22.12.1997 - shih f.2), anulimin e kanë kërkuar me parashtrësën e dt. 22.11.2013, respektivisht, me parashtrësën e dt. 10.10.2014 kur kërkojnë anulimin e përsëritshëm të testamentit (shih petitumet e tyre). Nga kjo rrjedhë se , nëse jo më herët, atëherë së paku me dt. 7.10.2011 paditësit kanë ditur për testamentin e testatorit, por që veprimet përkatse të lartëcekura janë marrë nga paditësit në datat e sipër përmendura, e kjo mëtej, d.m.th. pas afateve të parapara ligjore.

Kështu, nga se, me dispozitën e nenit 54 të Ligjit për Trashëgiminë (1974), veç tjerash, parashihet se anulimin e testamentit për shkak të paafësisë së trashëgimlënësit për të gjykuar ose nuk ka patur 16 vjet si dhe për shkak të kanosjes, shtrëngimit, mashtrimit ose lajthimit, mund t'a kërkojë vetëm personi që ka interes juridik, brenda afatit prej një viti nga dita kur ka marrë dijeni se ekzistojnë shkaqet e pavlefshmërisë e më së largu 10 vjet nga shpallja e testamentit, përkatësisht, anulimin e testamentit për mungesë të formës mund t'a kërkojë, pas hapjes së

trashëgimisë, vetëm personi që ka interes juridik, brenda afatit prej një viti nga dita që ka marrë dijeni për testamentin e më së largu brenda 10 vitesh pas shpalljes së testamentit(neni 69).

Nuk qëndron as pretendimi vijues i revizionit lidhur me marrëveshjen për ndarjen e pasurisë të dt.22.12.1997 dhe për kinse revidimin e pjesërishëm të testamentit nga testatori, për faktin sepse ajo marrëveshje nuk shihet se është nënshkruar nga trashëgimlënësi-testatori E. B.,e as nga I. Sh.,sikundër që e njëjta edhe nuk është e vërtetuar në ndonjë organ zyrtar, ndaj, si e tillë, ajo marrëveshje nuk mund të trajtohet si juridikisht e vlefshme.

Sa i përket revizionit të paditësve në kontekst të goditjes së aktgjykimit të shkallës së dytë edhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me dispozitën e nenit 214.2 parashihet se revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ,nga këtu, kjo Gjykatë, nuk e shqyrtojë revizionin sipas kësaj baze.

Për arsyet e sipërpërmendura revizioni i paditësve u refuzua si i pa themeltë, andaj, sipas dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.263/2016 datë 9.11. 2016

Kryetari kolegjit  
Mr.sc.Muhamet Rexha